



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1190/1 Prot.

Tiranë, më 02 . 11 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 224 , datë 02 . 11 . 2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 231 Regj., datë 26.10.2023, të shtetasit N. Xh, kundër: Drejtorisë së Hetimit Tatimor/Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtorisë së Policisë Vendore Fier dhe Bashkisë Fier, me pretendimin e diskriminimit për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, shtetasi N. Xh, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se, problematika e tij konsiston si më poshtë citohet:

*“Po ju drejtohem me këtë ankesë pasi ndihem i diskriminuar në ushtrimin e profesionit tim si shofer. Jam i licensuar që nga viti 2021 në shërbimin taxi 8+1, me nr. Nipti K328022419Q dhe bëj linjën Peshtan-Fier.*

*Problemi im qëndron se nuk po arrij të punoj nga konkurenca e pandershme që më bëhet nga persona të cilët përdorin makina personale dhe marrin pasagjerë, duke qenë të palicensuar për shërbim taxi.*

*Pasagjeri nuk do të më presë mua sa të mbush furgonin, por do të mbarojë punë sa më shpejt dhe, personat që përdorin makinat e tyre personale ikin dhe pa u mbushur me pasagjerë se nuk e kanë punë të mirëfilltë. Për këtë problem i jam drejtuar disa herë Bashkisë, Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, por nuk kam marrë zgjidhje. Ku është shteti që kontrollon?*

*I jam drejtuar disa here edhe Hetimit Tatimor, por përgjigja e tyre ka qenë: “Puno edhe ti si ata.”*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

*Unë jam qytetar i rregullt dhe dua që punën time ta bëj i qetë dhe të jem në rregull me ligjin, ndaj kërkoj të mos denigrohem, ose të mbyllin sytë edhe për mua.*

*I ndodhur në kushtet e konkurrencës së pandershme dhe të padrejtë po mbetem pa punë. Institucionet ia pasojnë topin njëri-tjetrit dhe unë mbetem i pambrojtur.*

*Ndihem i diskriminuar “për çdo shkak tjetër”, për shkak të profesionit që ushtroj, ndaj i drejtohem Komisionerit që t’i japë një zgjidhje situatës në të cilën ndodhem. Institucionet të veprojnë dhe jo të bëhen palë me informalitetin e të mbrojnë paligjshmërinë.”*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga institucionet përgjegjëse si dhe marrjen e masave ndaj paligjshmërive të pretenduara.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

*Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, si dhe referuar deklaratimeve të subjektit ankues, rezulton se:*

Referuar Licencës me nr. 017, datë 26.11.2021 “Për transport udhëtarësh me taxi”, lëshuar për personin N. Xh, nga Kryetari i Bashkisë Fier, me të dhënat:

- Tipi i autoveturës: Ford “Tranzit Tourneo”;
- Targa e taksisë: AE 77IT;
- Numri i taksisë: 0550;
- Numri i vendeve: 8 + 1;

ky dokument i jep të drejtën e përfshirjes në transportin taksi të udhëtarëve e bagazheve të tyre, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “për transportet rrugore”, subjektit ankues, për një kohëzgjatje të vlefshme nga data 26.11.2021, deri më datë 26.11.2026.

Ankuesi në thelb të ankesës së tij, pretendon për mosveprim të institucioneve përgjegjëse, lidhur me masat që duhet të ndërmerren për ndalimin e konkurrencës së pandershme dhe informalitetit, që i bëhet atij nga shoferët e tjerë të palicencuar për shërbimin taksi.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar për shkak se nuk punon dot për shkak të konkurrencës së pandershme dhe informalitetit të shoferëve që marrin pasagjerë me automjetet e tyre private, duke ushtruar një aktivitet të padeklaruar në organet shtetërore përgjegjëse, dhe duke dëmtuar aktivitetin e tij, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

*Së pari*, lidhur me pretendimin se Bashkia Fier dhe Drejtoria Vendore e Policisë Fier nuk i janë përgjigjur ankesave të tij, Komisioneri vlerëson se, referuar këtij momenti, mosveprimi institucional ka të bëjë me moszbatimin e shkëlqen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankuesit, se institucionet sipërcituar, nuk i janë përgjigjur kërkesave të tij; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ankuesit për moskthim përgjigje nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë, Fier dhe Bashkisë Fier, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>2</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e subjektit ankues për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

Së dyti, subjekti ankues ka cilësuar që është diskriminuar nga ana e institucioneve sipërcituar për “çdo shkak tjetër”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

*“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë<sup>3</sup>.”*

<sup>2</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

<sup>3</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

- Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh<sup>4</sup>. Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të

<sup>4</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>5</sup>.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*”

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive.*”

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

---

<sup>5</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikoj se cili është ky shkak.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk parashton fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga shkaqet e pretenduara.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Së treti, lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk punon dot për shkak të konkurrencës së pandershme dhe informalitetit të shoferëve që marrin pasagjerë me automjetet e tyre private, duke ushtruar një aktivitet të padeklaruar në organet shtetërore përgjegjëse, dhe duke dëmtuar aktivitetin e tij; Komisioneri vëren se, hetimi i tij nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Legjislacioni i brendshëm kombëtar ka përcaktuar autoritetet përgjegjëse si dhe ka rregulluar e normuar nëpërmjet dispozitave të posaçme ligjore, qoftë kompetencat e autoriteteve publike përkatëse, qoftë mënyrën e funksionimit e kontrollit të aktiviteteve të padeklaruar në organet shtetërore përgjegjëse, ushtrimin e konkurrencës së pandershme e informalitetit në Republikën e Shqipërisë.

### **Kuadri ligjor i cili parashikon sa më sipër:**

**Ligji nr. 8303, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”,** i ndryshuar, në nenin 1/a, të tij, ka përcaktuar se:

*“Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.”*

Neni 9

Shteti, nëpërmjet organeve të veta, organizon transportin e udhëtarëve, kur ai kryhet me mjete motorike, përveç atyre të përdorimit vetjak.

Transporti i udhëtarëve lejohet vetëm me mjete origjinale të prodhuara për këtë lloj transporti.

Kushtet që duhet të plotësojnë këto mjete përcaktohen me udhëzim të Ministrisë.

#### Neni 10

a) Mbajtësi i licencës, pas pagesës së çdo udhëtarë që përdor këtë shërbim, është i detyruar të pajisë atë me biletë ose faturë si provë e qenies së një kontrate mes tyre.

Të drejtat dhe detyrimet specifike të palëve janë përcaktuar në dispozitat e Kodit Civil.

b) Tarifat e transportit të udhëtarëve zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit "Për çmimet dhe tarifat".

Tarifat e transportit të udhëtarëve me subvencion nga shteti miratohen nga Këshilli i Ministrave.

c) tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.

ç) Tarifat e biletave të transportit rrethqytetës të udhëtarëve miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

#### Neni 12

Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet nëpërmjet:

a) shërbimeve në linja të rregullta, transporti qytetës, rrethqytetes dhe ndërqytetës;

b) shërbimeve të rregullta, të specializuara;

c) transporteve për llogari të vet;

ç) transporteve të rastit.

### **Kreu II.4- Transporti i udhëtarëve me taksi**

#### Neni 35

Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet.

Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Licenca për shërbimin taksi jepet me afat 5 vjet, me të drejtë rinovimi automatikisht, kur subjekti ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 36

Rregullat dhe kushtet për kërkesa të veçanta për taksitë, si dhe për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.

Niveli dysheme i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse)

Neni 38

Shërbimi me taksi pa licencë dhe me mjete të tjera jashtë atyre të përcaktuara në nenin 3, pika 3.6, është i ndaluar.

Kushtet dhe rregullat e përgjithshme për kryerjen e këtij lloj shërbimi përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## **Kreu VI - Kontrolli shtetëror dhe mbikëqyrja e kualifikuar në transportin rrugor**

Neni 64

Kontrollin shtetëror dhe mbikëqyrjen e kualifikuar në transportin rrugor e kryejnë organet e specializuara të kontrollit të transportit, sipas nenit 3, pika 3.16<sup>6</sup>.

Gjatë kësaj veprimtarie këto organe verifikojnë nëse transportuesit përmbushin detyrat e përcaktuara në këtë ligj dhe e ushtrojnë atë sipas licencave, lejeve dhe certifikatave. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

Neni 65

Personat e ngarkuar me detyrën e kontrollit/inspektimit shtetëror janë të autorizuar nga organi i specializuar i kontrollit dhe pajisen me dokumentin përkatës të identitetit si kontrollor/inspektor. Ata e ushtrojnë veprimtarinë sipas këtij ligji, duke verifikuar të gjithë dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor.

Neni 74

Kur organet e policisë rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, konstatojnë shkelje të këtij ligji, bashkëpunojnë me organet e specializuara për kontrollin dhe mbikëqyrjen e transportit dhe marrin masat përkatëse, sipas kompetencave që ka ky organ.

**VKM nr. 465, datë 26.08.2018 “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”,** ka vendosur, ndër të tjera, dhe funksionet e Task-Forcës:

Neni 4.

Task-Forca e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, ka këto funksione:

a) Kontrollin në terren, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë vendim dhe akteve ligjore në fuqi, për zbatimin e ligjshmërisë së aktivitetit të:

...

iii. terminaleve të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve, si dhe në vendqëndrimet e taksive;

b) Task-Forca për realizimin e objektivit të saj ka të drejtë të kryejë kontrollin e mjeteve në vende të veçanta, të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrin e Brendshëm;

<sup>6</sup> Neni 3, pika 3.16. Organe transporti janë organet dhe zyrat që merren me transportin në ministri e organet në varësi të saj, si dhe zyrat në qark, bashki.



- c) Hartimin e një plani masash administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e frytshmërisë së strukturave që ofrojnë shërbime për transportin rrugor, si dhe për evidentimin e ndalimin e përdorimit të kundërligjshëm në transportin rrugor të pasagjerëve dhe mallrave, të mjeteve që nuk plotësojnë kriteret tekniko-ligjore;
- ç) Bashkërendimin e punës me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policisë Rrugore, Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe institucionet e tjera shtetërore, për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të garantimit të zbatimit të kërkesave tekniko-ligjore prej operatorëve ekonomikë, që kryejnë transport pasagjerësh dhe mallrash;
- d) Bashkërendimin e punës me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Policisë Rrugore për ndërhyrjet e nevojshme për zbatimin e masave teknike;
- dh) Bashkërendimin e punës me strukturat e Policisë Rrugore, sipas qarqeve, për mbështetjen e veprimeve në terren të punonjësve të Task-Forcës, gjatë ndalimit të veprimtarive të kundërligjshme, që konstatohen gjatë ushtrimit të detyrës në terren;
- e) Bashkëpunimin me strukturat e Policisë Rrugore për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve të depozituara për shkeljet në këtë aktivitet prej operatorëve apo individëve të ndryshëm;
- ë) Kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për strukturat që ofrojnë shërbime për transportin rrugor dhe institucionet e tjera të ngarkuara në përputhje me këtë vendim...

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, ka publikuar në faqen e saj zyrtare<sup>7</sup>, rubrikën “Luftojmë informalitetin” Denoncime, duke ndarë informacionin e mëposhtëm:

*“Ju keni mundësinë të denonconi aktet korruptive apo sjelljet jo etike të punonjësve të Administratës Tatimore, si dhe evazionin fiskal apo shkeljen e ligjeve tatimore nga subjektet tatimpagues, të regjistruar ose jo, të cilat konstatohen nga Ju!*

*Gjithashtu, ju mund të dërgoni çdo problem apo shqetësim që keni me Administratën Tatimore, pyetje, kërkesa për sqarime etj, si dhe mund të raportoni rastet e shkeljeve që keni konstatuar në adresën [joinformalitetit@financa.gov.al](mailto:joinformalitetit@financa.gov.al), duke na ndihmuar në këtë mënyrë që të përmirësojmë punën tonë në lidhje me procedurat për zgjidhjen e çdo problemi apo shqetësimi si dhe pengesave që ju mund të keni me Administratën Tatimore.*

*Ju mund t'i paraqisni shqetësimet tuaja dhe mund t'i denonconi këto fenomene:*

*Duke telefonuar, pa pagesë nga një numër telefoni fiks ose celular në numrin: 0800 14 14. Gjatë orarit zyrtar të punës (8:00 – 16:30, nga e hëna në të enjte, dhe 8.00-14 të premtën) një punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do t'ju përgjigjet dhe do t'ju shërbejë. Në ditët e pushimit zyrtar dhe jashtë orarit zyrtar të punës (nga ora 16:30 - 08:00 nga e hëna në të enjte dhe pas orës 14.00 të premtën) ju mund të lini një mesazh në këtë numër telefoni, duke paraqitur shqetësimin apo denoncimin tuaj.*

*Duke dërguar e-mail në adresën e postës elektronike: [denoncime@tatime.gov.al](mailto:denoncime@tatime.gov.al)*

<sup>7</sup> <https://www.tatime.gov.al/c/8/64/luftojme-informalitetin>

*Duke përdorur formularin "Informacion për Akte Abuzive", të cilin mund ta shkarkoni duke klikuar këtu.*

*Duke dërguar mesazh, foto apo video në Ëhatsapp dhe Viber në numrin 069 70 73 733*

*Formularin e plotësuar, Ju mund ta dërgoni:*

*Me postë në adresën: Sektori i Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rr. "Gjin Bue Shpata" (mbrapa Stadiumit "Selman Stërmasi"), 1001, Tiranë.*

*Duke e dorëzuar dorazi në Sektorin e Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në adresën Rr. "Gjin Bue Shpata" (mbrapa Stadiumit "Selman Stërmasi"), 1001, Tiranë."*

Pra, bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, çdo pretendim për evazion fiskal, shkelje të ligjeve tatimore nga shoferët e përmendur prej tij, apo shkelje të çdo natyre tjetër të informalitetit a konkurrencës së pandershme, duhet t'i paraqesë në strukturat përkatëse përgjegjëse për trajtimin e tyre.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, i cili citon se "Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim", ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues N. Xh, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**